



Analizë e raporteve vjetore



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Cooperation Office Kosovo

MINISTRY OF FOREIGN AFFAIRS OF DENMARK

DANIDA | INTERNATIONAL
DEVELOPMENT COOPERATION

Analizë e INDEP për Raportin Vjetor të ARKEP për vitin 2017

Ky botim është realizuar me përkrahjen e projektit Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF). Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Institutit për Politika Zhvillimore dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet si qëndrim i SCO-K-së, DANIDA-së apo KCSF-së.

Hyrje

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), në kuadër të programit për qeverisje demokratike dhe punës mbështetëse për Komisionin parlamentar për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri (Komisioni) ka analizuar raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ për Komunikime Elektronike dhe Postare (ARKEP). Puna e INDEP është mbështetur në parimet e pavarësisë, paanshmërisë dhe hulumtimit të pavarur.

Raporti i ARKEP për aktivitetet dhe performancën në vitin 2016 përmbush kërkesat nga Manuali për Raportim të Agjencive të Pavarura, një dokument i hartuar me iniciativën e Komisionit në vitin 2014 dhe i cili është shpërndarë tek të gjitha agjencitë që i raportojnë Kuvendit të Kosovës. Në tërësinë e tij, raporti i është përmbajtur këtij Manuali dhe ka ofruar një mori të dhënash për funksionimin e Rregullatorit, tregut dhe operatorëve të tij, bazën ligjore dhe sfidave për të ardhmen.

Për INDEP, raportimi vjetor i agjencive të pavarura dhe rregullatorëve të tregut është një mundësi e mirë për Kuvendin që ta mbikëqyrë punën e tyre, por edhe e këtyre institucioneve që t'i adresojnë problemet dhe sfidat që kanë në mënyrë që Kuvendi të mund të kontribuojë në përmirësimin e tyre. Me gjithë insistimin e Komisionit Evropian, INDEP-it dhe hisedarëve të tjerë, raporti vjetor mbetet edhe më tutje i vetmi instrument i drejtpërdrejtë i ushtrimit të mbikëqyrjes parlamentare.

Në përfundim të çdo viti, Autoriteti paraqet në Kuvend, brenda gjashtë mujorit të parë të vitit pasardhës, raportin vjetor të veprimtarisë së vitit paraprak.¹ Në bazë të ligjit, ARKEP duhet ta dorëzojë raportin brenda gjashtë mujorit të parë të vitit vijues. Megjithatë, për shkak të shpërndarjes së Kuvendit dhe organizimit të zgjedhjeve të parakohshme, raporti për vitin 2016 po shqyrtohet tek në fillim të nëntorit të vitit 2017, që paraqet një hendikep të madh. Çfarëdo rekomandimi që mund të japë Komisioni, ARKEP do të duhet ta adresojë në këta dy muajt e mbetur të vitit 2017 ose eventualisht në vitin 2018 që do të ishte objekt mbikëqyrjeje e Kuvendit tek mbas dy vitesh.

Komunikimet elektronike, digjitalizimi dhe kompetencat e tjera që i ka ARKEP me Ligjin Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike janë tejet të rëndësishme edhe për procesin integruar por edhe për transformimin e komunikimeve elektronike në funksion të zhvillimit ekonomik. Në Raportin e Komisionit Evropian për Kosovën përmenden një sërë sfidash në fushën e digjitalizimit. Nuk ka pasur progres në përmirësimin e pavarësisë financiare dhe organizative të ARKEP.² Këto sfida janë përmendur edhe në raportin e ARKEP të cilin po e shqyrtojmë tani.

¹ Republika e Kosovës, (2012), Ligji Nr. 04/L-109 për Komunikimet Elektronike, Neni 11, paragrafi 2, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2851> (qasur në tetor, 2017).

² Komisioni Evropian, (2017), Raporti për Kosovën për vitin 2016, fq.61 i qasshëm në https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2016/20161109_report_kosovo.pdf (qasur në tetor, 2017)

Baza ligjore dhe pavarësia financiare e Rregullatorit

Në raport është rënditur baza e tanishme ligjore dhe nuk është raportuar nëse ka ndonjë vështirësi me implementimin e saj. Edhe pse në raportin e KE kërkohet “plotësim i bazës ligjore”, ARKEP nuk ka raportuar për ndonjë vështirësi në implementimin e bazës aktuale ligjore. Megjithatë, ARKEP është ankuar për mungesë të stafit adekuat. Me gjithë progresin e vazhdueshëm sfidë mbetet sigurimi i numrit të mjaftueshëm të stafit për realizimin e objektivave të përcaktuara për ARKEP.³ Kjo mungesë e resurseve humane ka ardhur kryesisht si pasojë e mungesës së pavarësisë buxhetore të Rregullatorit.

ARKEP është ballafaquar me shkurtime buxhetore.⁴ Mbi 50 mijë euro i ishin shkurtuar ARKEP në masën më të madhe nga kategoria e shpenzimeve kapitale. Megjithatë, raporti nuk ka sqaruar se deri në ç’masë shkurtimeve buxhetore kanë ndikuar në performancën e Rregullatorit. Çfarë ka mbetur pa u realizuar si rezultat i shkurtimeve buxhetore dhe çfarë mund të bëjë Komisioni që ta mundësojë një përmirësim të tillë.

Si edhe viteve të kaluara, buxheti është raportuar vetëm në linja të trasha. Komisioni duhet të informohet cilat projekte kapitale janë realizuar dhe nëse buxheti është shpenzuar për të realizuar misionin e Rregullatorit. Në këtë kuptim, është qëndrim i INDEP që edhe Komisionet funksionale duhet të marrin një raport të detajuar financiar për të parë nëse shpenzimi i buxhetit po i shërben mbërritjes së objektivave funksionale të Rregullatorit.

Ankesat e konsumatorëve të shërbimeve postare

Në raportin e sivjetmë të Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare është raportuar për një numër të madh të ankesave të qytetarëve ndaj shërbimeve postare që nuk kanë arritur të zgjidhen. ARKEP nuk sqaron arsyet se përse një pjesë e konsiderueshme e ankesave të qytetarëve nuk janë zgjidhur. Ndër përgjegjësitë e Autoritetit është edhe mbrojtja e konsumatorëve dhe adresimi i ankesave të tyre është i domosdoshëm për të siguruar një treg që ofron shërbime kualitative.

44% e ankesave të konsumatorëve për shërbimet postare nuk janë zgjidhur

Trajnimet dhe resurset huamane

Në këtë raport, ARKEP është ankuar për mungesë të stafit profesional dhe për pamundësi për ta ruajtur atë aktual në mungesë të kushteve atraktive për punë. Në pjesën e trajnimeve, raporti rëndit dy trajnime por nuk shpjegon shumë natyrën e tyre dhe se çfarë ka përfituar drejtpërdrejtë ARKEP. Për më tepër, në shtojcë nuk janë paraqitur lista e trajnimeve të mbajtura deri më tani.

Në bazë të Objektivave të paraqitura në faqe 81 të raportit, ARKEP është dashur të hartojë Plane të Trajnimeve dhe Konferencave/Workshopeve dhe këtë për periudhën 2015-2017. Nuk

³ Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – ARKEP, (2017), Raporti Vjetor për vitin 2016, faqe 19, Prishtinë: ARKEP.

⁴ Ibid, faqe 86.

është sqaruar se a është hartuar ky plan dhe se sa ky plan është implementuar në vitin 2016 dhe nëse është mungesa e buxhetit arsye për mospjesëmarrje në më shumë se dy trajnime/konferenca gjatë vitit 2016.

Investimet

Si edhe gjatë gjithë raportit, edhe në pjesën e investimeve të bëra në rrjete dhe shërbime telekomunikuese nuk ka pasur aspak analizë. Janë paraqitur të dhëna por nuk është përdorur asnjë metodë analize për të ofruar një perspektivë më të qartë për akterët të cilët nuk punojnë çdo ditë në këtë fushë. Raporti lavdëron se në vitin 2016 ka pasur 29 milion euro investime në rrjet dhe shërbime por nëse shohim raportet paraprake të ARKEP vërejmë që në tre vitet e fundit ka rënie të konsiderueshme të investimeve.




Figura 1. Investimet e bëra në rrjete dhe shërbime telekomunikuese në tre vitet e fundit. BURIMI: Raportet e ARKEP

Derisa në vitin 2014 ka pasur investime prej 52 milion eurove, kjo shifër ka rënë në vitin 2016 në vetëm 29. Raportit në tërësinë e tij i mungon krahasimi, analiza e kontekstit dhe sqarimi i numrave në kuptim të funksionimit të tregut dhe zhvillimit ekonomik. Nëse në pjesën e penetrimit të telefonisë mobile është thënë se shkalla e penetrimit është më e ultë se e vendeve të rajonit⁵ nuk është tentuar të sqarohen arsyet përse një gjë e tillë po ndodh. Raportit të ARKEP në pjesën më të madhe të tij nuk i mungojnë numrat, por analiza e tyre.

⁵ Në faqe 103 të Raportit.

Përfundime

Raporti vjetor i Autoritetit Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare është hartuar në përputhje me Manualin për Raportim të Agjencive të Pavarura, hartuar nga Komisioni dhe shpërndarë tek të gjitha agjencitë e pavarura. Shqyrtimi i raportit vjetor për vitin 2016, në nëntor të vitit 2017 është një mangësi e madhe dhe çdo përfundim i Komisionit duhet të adresohet në më pak se dy muaj dhe eventualisht tek në vitin tjetër.

Raporti pasqyron në tërësi përmban informata të shumta. Ato, në shumicën e pjesëve të tij, nuk janë shoqëruar me një analizë të gjendjes paraprake, të rëndësisë së zhvillimeve të raportuara dhe e kontekstit të çështjes. Analiza e raporteve paraprake, krahasimi me vendet e tjera dhe me sektorë të tjerë do të mund të ndihmonte në të kuptuarit më substancial të fushës dhe progresit në vitin 2016.

Edhe në Raportin e Komisionit Evropian, por edhe në raportet paraprake të Autoritetit, është alarmuar për mungesë të pavarësisë financiare të ARKEP-it. Vetëm buxheti për investime kapitale në vitin 2016 pothuaj i ishte përgjysmuar ARKEP-it pas rishikimit buxhetor. Edhe në të kaluarën INDEP ka alarmuar për mungesën e mekanizmave të Kuvendit për mbikëqyrje funksionale në njërin anë dhe në anën tjetër, për mungesën e pavarësisë buxhetore që pjesa më e madhe e rregullatorëve dhe agjencive të pavarura e kanë.

Një pjesë e rëndësishme e rolit që ka rregullatori është mbrojtja e konsumatorëve. Nëse 44% e ankesave ndaj shërbimeve postare kanë mbetur të pazgjidhura në vitin 2016, i bie që ky mision nuk është përmbushur sa duhet. Në raportet vjetore së paku duhet dhënë një listë arsyesh se përse ka ndodhur një gjë e tillë. Gjithashtu, ARKEP duhet të sqarojë se a ka një sistem të brendshëm të menaxhimit të ankesave dhe se sa është punuar në zgjidhjen dhe zvogëlimin e tyre.

Duke analizuar raportet e kaluara, ne gjetëm se ka një trend të rënies së investimeve në rrjete dhe shërbime telekomunikuese. Të dhënat e raportit fjasin qartësisht për nevojën që të ketë më shumë penetrim të teknologjive të komunikimit. Çfarë do të thotë rënia gati përgjysmë në vetëm dy vite të investimeve!? A do të thotë se infrastruktura është kompletuar apo se tregu ka ngecur së zhvilluari? ARKEP duhet t'i zgjerojë informatat që ofron nga thjesht numra dhe të dhëna në të dhëna krahasuese dhe shpjegime shtesë për temat dhe sektorët që raporton.

Nga pesë çështjet e gjetura nga Auditori për vitin 2015 e që është dashur të adresohen në vitin 2016, ARKEP ka raportuar se janë adresuar vetëm dy, kurse tri janë në proces të adresimit. Nuk është dhënë ndonjë sqarim shtesë se përse nuk janë realizuar rekomandimet e Auditorit dhe se ku kanë qenë pengesat që për një vit nuk janë implementuar kërkesat e auditorit. ARKEP gjithashtu duhet të sqarojë se a është bërë Plani i Trajnimeve dhe Konferencave 2015-2017 i paraparë dhe se a ekziston një listë e të gjitha trajnimeve të kryera.

Marrë në tërësi, raporti vjetor i ARKEP për vitin 2016 ofron informata të shumta. Atyre u mungon një analizë e rrethanave, pasojave, numrave nga vitet e kaluara etj. Në shumë pjesë duket të mos jetë shumë koherent dhe të jetë një përmbledhje copëzash më tepër sesa të jetë shkruar në një frymë! Përfundimisht, diskutimi për një raport të tillë është i rëndësishëm pasi për Komisionin raporti vjetor mbetet instrumenti praktikisht i vetëm për të mbikëqyrrur sektorin dhe për t'u informuar rreth tij.

“Kjo analizë është financuar nga projekti Promovimi i Shoqërisë Demokratike (DSP) – i financuar nga Zyra Zvicerane për Bashkëpunim në Kosovë (SCO-K) dhe Ministria e Punëve të Jashtme e Danimarkës (DANIDA) dhe menaxhuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF)”.